

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2746 Prot.

Durrës, më 25. 11.2025

V E N D I M

Nr. 160, Datë 25. 11.2025

P Ë R

**“HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER
PROFESIONAL NË “SIPËRMARRJE DHE TRANSFORMIM DIGJITAL”, PRANË
FAKULTETIT TË BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”
DURRËS”**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar”; në Statutin e UAMD-së neni 5, neni 15, neni 59; në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore të FB me nr. 2583/2 prot., datë 20.11.2025, si edhe në relacionin Nr. 2583/3 prot., datë 21.11.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Sipërmarrje dhe Transformim Digjital”, pranë departamentit të Menaxhimit, në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën **Shqipe**.

3. Kodi i programit të studimit: **71MP0413S**.
4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

